

ASOCIATION
"LOYOLA-GYMNASIUM"

KODI
I
ETIKËS DHE MIRËSJELJES

Prizren, shtator 2024



Përmbajtja

I.	HYRJE	3
II.	QËLLIMI I DOKUMENTIT.....	3
III.	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME.....	3
IV.	STAFI I SHKOLLËS	4
	a. Të drejtat:.....	4
	b. Detyrimet:.....	4
V.	UDHËHEQËSIA E SHKOLLËS.....	5
	a. Të drejtat:.....	5
	b. Përgjegjësitë:	5
VI.	DREJTORI I SHKOLLËS	5
	a. Të drejtat:.....	5
	b. Përgjegjësitë.....	5
VII.	MËSIMDHËNËSIT	6
	a. Të drejtat:.....	6
	b. Përgjegjësitë:	6
VIII.	NXËNËSIT	7
	a. Të drejtat:.....	7
	b. Përgjegjësitë:	7
	c. Ndalesat:.....	8
IX.	PRINDËRIT/KUJDESTARËT	9
	a. Të drejtat.....	9
	b. Përgjegjësitë.....	10
X.	PËRDORIMI RESURSEVE	10
XI.	VEPRIMET QË MUND TË NDËRMERREN NËSE KODI I ETIKËS DHE MIRËSJELLJES ËSHTË SHKELUR	11
XII.	DISPOZITA TË TJERA.....	12



I. HYRJE

Në bazë të nenit 5, pika (i) të Ligjit mbi Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, Ligjin për Arsimin Parauniversitar në Republikën e Kosovës Nr. 04/L- 032 dhe nenit 84 të Ligjit të punës së Republikës së Kosovës nr.03/L-212 të dt.01.XI.2010, dhe në bazë të kontributeve të nxjerra nga punëtorja e mbajtur me stafin administrativ dhe edukativ të shkollës më datë 25 Gusht 2017, pas takimit të Këshillit të Përgjithshëm të Shkollës më datë 01.11.2017, Asociation "Loyola Gymnasium" (tutje referuar edhe si "ALG") miraton këtë Kod të Etikës dhe Mirësjelljes.

II. QËLLIMI I DOKUMENTIT

"Loyola-Gymnasium" është një vend ku nxënësit dhe të rinjtë mësojnë dhe kuptojnë historinë dhe rrënjët e njerëzimit, fitojnë diturinë dhe shprehinë e krijimit të ideve, mësojnë të shijojnë arritjet, të ballafaqohen me humbjet dhe të zhvillojnë mjetet e domosdoshme për ndërtimin e një të ardhmeje të përbashkët. Në këtë mënyrë shkolla jonë përpiqet të inkurajojë nxënësit e saj me kompetencë, vetëdije dhe përkushtim të dhembshur.

Në të njëjtën kohë ne përpiqemi të ofrojmë edukim për demokraci, që është elementi kyç për zhvillimin demokratik të një shteti.

Për më tepër, ne e shohim veten si një element në sistemin e edukimit të Kosovës prandaj, në bazë të marrëveshjes mbi themelimin e shkollës, ne i respektojmë ligjet dhe udhëzimet e Kosovës.

Për t'i arritur këto qëllime, "Loyola-Gymnasium" duhet të jetë një vend i sigurt ku secili është i vetëdijshëm për të drejtat dhe detyrat e tij. Kodi ynë i Etikës dhe Mirësjelljes siguron udhëzime në mënyrë që të realizohet mësimi i qëllimshëm dhe nevojat e të gjithëve të përbushen.

III. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

- a. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes parashikon një sërë rregullash dhe parimesh etike, të cilave duhet t'iu përmbahen të gjithë pjesëtarët e komunitetit të shkollës "Loyola-Gymnasium", (tutje referuar si "Shkolla"), pa dallim pozite, moshe, gjinie, etnie, feje, apo përcaktimi politik.
- b. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes rregullon të drejtat dhe detyrimet e mbajtësve të aktiviteteve të drejtpërdrejta edukativo-arsimore që kanë të bëjnë me sjellje të përshtatshme kundrejt punonjësve të tjerë, kolegëve, nxënësve të shkollës, bashkëmoshatarëve, prindërve të nxënësve dhe palëve të tjera.
- c. Kodi i Etikës dhe Mirësjelljes promovon kulturë etike të ndërveprimit në punët që kryhen për shkollën me anë të krijimit të një ambienti të shëndoshë të punës, ku dominojnë raportet korrekte të bashkëpunimit, respektimi i ligjeve në fuqi, rregulloreve të brendshme dhe objektiviteti në kryerjen e detyrave, për të gjithë pjesëtarët komunitetit të shkollës.
- d. Punonjësit e shkollës marrin pjesë në themelimin, mbajtjen dhe zbatimin e standardeve të larta të sjelljes kështu që respektimi, ndershmëria, paanësia dhe objektiviteti i shkollës duhet të jetë i mbrojtur si në raport të brendshëm, ashtu edhe të jashtëm.
- e. I tërë stafi i punonjësve të shkollës e ka për detyrë të kontribuojë drejt krijimit të një mjedisi



pozitiv dhe produktiv pune.

- f. Vendi i punës sipas këtij Kodi të Etikës dhe Mirësjelljes, nënkupton çdo hapësirë punuese ku i punësuari kryen punët dhe detyrat e punës.
- g. Hapësirat e shkollës janë të kushtuara për gjithë komunitetin e ALG-së.
- h. Në kabinete, parimisht, nxënësit qëndrojnë vetëm në praninë e mësimit të tyre.
- i. Në terrane dhe në salla sportive mund të hyhet gjithashtu vetëm nën mbikëqyrje të mësimit të përgjegjës, duke pasur parasysh rregullat në fuqi mbi shfrytëzimin e tyre.

IV. STAFI I SHKOLLËS

a. Të drejtat:

- i. Trajtohen në mënyrë të drejtë dhe të barabartë;
- ii. Trajtohen me respekt;
- iii. Informohen me kohë për ndryshimet në shkollë;
- iv. Ankohen pa ndjenjë të diskriminimit.

b. Detyrimet:

- i. Respektojnë: ligjet, rregulloret e brendshme, aktet nënligjore, praktikat e punës dhe standardet e përgjithshme të punës të cilat janë të aplikueshme në Kosovë;
- ii. Sillen me respektin më të madh, veprojnë në mënyrë profesionale dhe të paanshme si ndaj nxënësve, ashtu edhe ndaj kolegëve/kolegeve të tyre;
- iii. Kryejnë detyrat e tyre në përputhje të plotë me parimet e objektivitetit, të drejtësisë, të transparencës dhe të mosdiskriminimit;
- iv. Kryejnë punën e tyre ndershmerisht, zellshëm dhe me përgjegjësi të lartë;
- v. Shmangin secilin aktivitet joligjor apo pjesëmarrjes në akte diskredituese për shkollën;
- vi. Respektojnë dhe kontribuojnë në objektivat legjitime dhe etike të shkollës;
- vii. Marrin pjesë aktive në zhvillimin e strategjive të ndryshme të shkollës që lidhen me punën e tyre;
- viii. Janë të matur gjatë përdorimit dhe mbrojtjes së informacioneve të siguruar gjatë kryerjes së detyrave të tyre;
- ix. Kujdesen për mbajtjen e pastërtisë në hapësirat shkollore;
- x. Kushtojnë kujdes klasifikimit të mbeturinave;
- xi. Paraqesin në administratë, ose tek kujdestari i klasës dëmtimet dhe ndotjet ashtu që të evitohet problemi.



V. UDHËHEQËSIA E SHKOLLËS

a. Të drejtat:

- i.** Presin bashkëpunim nga të gjithë bashkëpunëtorët, nxënësit dhe prindërit;
- ii.** Presin kontribute dhe propozime për zhvillimin dhe ngritjen e cilësisë në mësimdhënie dhe mësimnxënie;
- iii.** Konsultohen për çfarëdo paqartësie, sidomos në rastet kur institucionet e tjera, si psh. kujdestari i klasës, përfaqësuesi i prindërve, etj. nuk rezultojnë me sukses.

b. Përgjegjësitë:

- i.** Sigurojnë kushte për të gjithë të përfshirët në jetën shkollë për t'i kryer detyrat e tyre dhe për të realizuar të drejtat e tyre;
- ii.** Përkrahin dhe udhëzojnë anëtarët e stafit;
- iii.** Zhvillojnë procesin e zhvillimit pedagogjik të shkollës, identifikojnë dhe korrigjojnë devijimet e mundshme dhe pajisin shkollën me të gjitha mjetet e nevojshme si personelin, infrastrukturën dhe programet;
- iv.** Pranojnë dhe hetojnë ankesat e drejtuara tek ata.

VI. DREJTORI I SHKOLLËS

a. Të drejtat:

- i.** Pret besnikëri, sinqeritet dhe bashkëpunim nga të gjithë bashkëpunëtorët dhe nxënësit, por edhe nga prindërit;
- ii.** Cakton ndonjë koleg për të marrë përsipër përgjegjësinë për detyra të caktuara të përcaktuara qartë.

b. Përgjegjësitë

- i.** Ushtron kujdes për zbatimin ligjeve, rregulloreve të brendshme, akteve nënligjore, si dhe kujdeset që praktikantët e punës dhe standardet e përgjithshme të punës të jenë në përputhje me praktikantët dhe standardet e aplikueshme në Kosovë;
- ii.** Sigurohet që të gjithë punonjësit të marrin nga një kopje të këtij Kodi dhe të lexojnë e kuptojnë kërkesat e tij;
- iii.** Sigurohet që të gjithë punonjësit të kuptojnë detyrën e tyre për të raportuar shkeljet, veprimet e dyshuara, ose parregullsitë ligjore të këtij Kodi.



VII. MËSIMDHËNËSIT

a. Të drejtat:

- i. Presin bashkëpunimin e nxënësve gjatë zbatimit të programit të tyre mësimor;
- ii. Presin që ata do të jenë në gjendje të mësojnë në një mjedis të rregullt dhe bashkëpunues;
- iii. Presin mbështetjen e personelit tjetër dhe administratës në përmbushjen e detyrave të tyre profesionale;
- iv. Ruajnë fleksibilitetin në qasjen e tyre ndaj procedurave në klasë dhe organizimin në kuadër të politikës së shkollës;

b. Përgjegjësitë:

- i. Trajtojnë nxënësit në mënyrë të drejtë në vazhdimësi;
- ii. Ofrojnë tërësinë e duhur të strategjive të të mësuarit;
- iii. Ndërmarrin këshillim të nxënësve dhe rolin prijës kur është e përshtatshme;
- iv. Zhvillojnë tek nxënësit vetëdijësimin dhe të kuptuarit e rregullave të shkollës;
- v. Zbulojnë dhe mbështesin talentin e ndonjë nxënësi në veçanti;
- vi. Mbështesin nxënësit dhe marrin pjesë aktive në të gjitha manifestimet shkollore të parapara si të detyrueshme (psh. festat e shkollës, ditët e vetëdijësimit, festat sportive, ekskursionet);
- vii. Japin propozimet e veta në të gjitha fushat e jetës shkollore;
- viii. Janë iniciatorë për aktivitete të ndryshme edukativo-kulturore;
- ix. Ndjekin politikat dhe procedurat e miratuara të shkollës në lidhje me menaxhimin e nxënësve;
- x. Komunikojnë me prindërit dhe kujdestarët në çështjet që lidhen me zhvillimin arsimor dhe sjelljen e fëmijëve të tyre;
- xi. Janë të përpiktë dhe të përgatitur;
- xii. Vishen formalisht, në një veshje të rregullt e cila nuk e prish imazhin e shkollës;
- xiii. Përdorin gjuhë respekti në shkollë dhe me të gjitha palët;
- xiv. Mësimdhënësit kujdestarë klase i përkushtohen detyrës së tyre si përgjegjës të nxënësve të një klase me vullnet dhe paanshmëri;
- xv. Mësimdhënësit kujdestarë dite kryejnë punën e tyre me përgjegjësi të plotë, duke iu përmbajtur planit të kujdestarisë.



VIII. NXËNËSIT

a. Të drejtat:

- i. Ndjehen të sigurt në shkollë;
- ii. Mësojnë në një mjedis sfidues për të mirë të aftësisë së tyre;
- iii. Trajtohen me respekt nga nxënësit dhe mësuesit e tjerë;
- iv. Dëgjojnë nga mësimdhënësit dhe nxënësit e tjerë;
- v. Shfrytëzojnë burimet e shkollës për qëllime zhvillimi, me leje dhe mbikëqyrje të mësimdhënësve apo stafit administrativ;
- vi. Njoftohen për zhvillimet e reja brenda shkollës;
- vii. Japin propozimet e veta në të gjitha fushat e jetës shkollore, sidomos në mësim.

b. Përgjegjësitë:

- i. Pranojnë politikat e shkollës në lidhje me sjelljen e tyre;
- ii. Respektojnë Kodin e Etikës dhe të Mirësjelljes, rregullat e brendshme dhe çdo akt tjetër të shkollës;
- iii. Veprojnë dhe punojnë bashkërisht me nxënësit dhe mësuesit e tjerë;
- iv. Respektojnë nevojat e të mësuarit të nxënësve të tjerë;
- v. Marrin përgjegjësi progresive për avancimin e tyre, për të punuar në mënyrë të vazhdueshme dhe për të kryer detyrat në plotni, siç kërkohet;
- vi. Janë tolerantë ndaj dallimeve mes bashkëmoshatarëve;
- vii. Ndjekin mësimin dhe marrin pjesë në të gjitha manifestimet shkollore të parapara si të detyrueshme (psh. festat e shkollës, ditët e vetëdijësimit, festat sportive, ekskursionet).
- viii. Angazhohen me të gjitha mjetet e tyre për të mësuar dhe studiuar në të gjitha format e mundshme, brenda dhe jashtë klasës, por edhe në ekskursionet ose praktika për të cilat shkolla rezervon të drejtën t'i bëjë ato të detyrueshme;
- ix. Veshin uniformën në mënyrë të rregullt gjatë gjithë kohës që ndodhen në shkollë. Në klasë nxënësi nuk mund të veshë ndonjë gjë tjetër, përpos uniformës;
- x. Mbështesin reputacionin e shkollës, duke respektuar një standard të përshtatshëm të sjelljes dhe dukjes gjatë kohës për në dhe nga shkolla, sidomos kur kanë të veshur uniformën e shkollës;
- xi. Tatuazhe të dukshme, piercing dhe frizurat e papërshtatshme nuk janë të lejuara dhe mund të shpiejnë në suspendim apo përjashtim;
- xii. Informojnë prindërit për progresin e tyre arsimor dhe përcjellin komunikimin nga shkolla në mënyrë efektive;
- xiii. Pranojnë autoritetin e anëtarëve të stafit dhe respektojnë rregullat e veçanta të cilat mund të bëhen nga koha në kohë;
- xiv. Sillen në një mënyrë që nuk e rrezikon shëndetin dhe sigurinë e vetes apo të të tjerëve,



përfshirë shëndetin mendor;

- xv. Sillen me mirësjellje dhe konsideratë për të tjerët. Në veçanti, nxënësit duhet të përmbahen nga të gjitha format e ngacmimit, siç përshkruhen në Politikën për Mbrojtjen e Fëmijëve të shkollës;
- xvi. Shmangin sjelljet e papërshtatshme me njëri-tjetrin dhe komunitetin e shkollës, gjatë kohës që kanë të veshur uniformën e shkollës dhe e përfaqësojnë atë, pa marrë parasysh nëse sjellja e papërshtatshme ndodh brenda apo jashtë kampusit të shkollës;
- xvii. Janë transparentë me stafin shkollor për çdo sjellje të papërshtatshme të nxënësve të shkollës dhe komunitetin e shkollës;
- xviii. Përmbahen nga veprimet dhe sjelljet e papërshtatshme të cilat do të kishin ndikim negativ në reputacionin e shkollës dhe komunitetit të saj;
- xix. Përmbahen nga sjellja e cila do të ndërpriste punën e çdo klase, ose do të pengonte mundësitë e të mësuarit të nxënësve të tjerë;
- xx. Nuk përdorin punën akademike të dikujt tjetër për ta prezantuar si të tyre, pa e cituar burimin e atij informacioni;
- xxi. Nuk dorëzojnë të njëjtin punim më shumë se një here;
- xxii. Nuk mashtrojnë në teste, provime, kuize apo cilëndo formë tjetër të vlerësimit;
- xxiii. Nuk ndihmojnë ndonjë nxënës tjetër në arritje të çfarëdo suksesi, duke mashtruar;
- xxiv. Marrin pëlqimin nga udhëheqja e shkollës në rast se dëshirojnë të shpërndajnë apo të shesin gazeta, fletëpalosje apo të ngjashme në objektin e shkollës;
- xxv. Marrin autorizimin e udhëheqjes së shkollës në rast të hapjes së ndonjë webfaqeje apo llogarie në ndonjë media sociale, pasi nuk mund të përfaqësojnë shkollën në media sociale.
- xxvi. Nxënësit të cilët nuk qëndrojnë në konvikt janë të detyruar t'u përmbahen rregullave të përgjithshme të shkollës, të cilat bazohen në rregullat e shkollës me konvikt;
- xxvii. Nxënësit të cilët qëndrojnë në konvikt në asnjë moment nuk duhet ta shfrytëzojnë praninë e tyre në konvikt për të krijuar ndonjë përparësi në raport me jokonviktoret, sepse detyrimet, detyrat në shkollë dhe aktivitetet jashtëmësimore (ekskursionet, aktivitetet kulturore, artistike, sportive etj.) vlejnë për të gjithë.

c. Ndalesat:

Ndalesat e përcaktuara në këtë Kod të Etikës dhe Mirësjelljes, vlejnë për nxënësit gjatë kohës që gjenden brenda kampusit të shkollës, jashtë asaj nëse ende mbajnë uniformën e veshur, në udhëtime zyrtare me shkollën jashtë vendit, në ekskursione apo të ngjashme. Shkelja e këtyre rregullave, përfshirë edhe shkeljen e përgjegjësive, i jep të drejtë shkollës të shqiptojë masat e përshtatshme në përputhje me aktet e brendshme të aplikueshme.

- i. Ndalohet rreptësisht konsumimi/posedimi i duhanit, substancave narkotike dhe substancave të tjera, si brenda dhe jashtë kampusit të shkollës, përfshirë çdo mjedis të lidhur me shkollën gjatë aktiviteteve shkollore apo jashtëshkollore;



- ii. Ndalohet rreptësisht përdorimi i telefonit mobil dhe çdo pajisjeje tjetër elektronike gjatë orëve mësimore, apo aktiviteteve shkollore, përveç rasteve të miratuara nga mësimdhënësit për qëllime edukative, apo informuese në raport me familjarët e tyre;
- iii. Ndalohet rreptësisht përdorimi, mbajtja apo shpërndarja e alkoolit dhe substancave të paligjshme brenda dhe jashtë kampusit, gjatë aktiviteteve të lidhura me shkollën;
- iv. Nxënësit duhet të respektojnë kodin e veshjes së përcaktuar nga shkolla, uniformën, dhe ndalohet veshja e rrobave me mesazhe fyese, diskriminuese, apo që promovojnë dhunën dhe substanca të paligjshme;
- v. Ndalohet largimi nga kampusi gjatë orarit shkollor pa lejen e mësuesit kujdestar, ose drejtorisë së shkollës, apo largimi nga shkolla për një kohë më të gjatë e cila do të kishte ndikim negativ në vitin shkollor të nxënësit;
- vi. Ndalohet rreptësisht mbajtja e çdo lloj arme, arme të ftohtë apo objekti të rrezikshëm që mund të përdoret për të dëmtuar veten apo të tjerët;
- vii. Ndalohet rreptësisht çdo lloj dhune ndaj nxënësve të tjerë apo personave tjerë që gjenden brenda ambientit të shkollës, si dhe çdo lloj dhune e nxënësve gjatë kohës kur nxënësit mbajnë uniformën e shkollës;
- viii. Ndalohet çdo formë e dëmtimit të qëllimshëm të pronës së shkollës, apo të të tjerëve; do të ndëshkohet në përputhje me rregullat e shkollës dhe legjislacionin në fuqi;
- ix. Ndalohet çdo sjellje e nxënësve që rrezikon sigurinë gjatë transportit të nxënësve përmes mjeteve të transportit;
- x. Ndalohet rreptësisht çdo sjellje e nxënësve ndaj njëri-tjetrit dhe komunitetit të shkollës, që përkufizohet si bullizëm apo sjellje e papërshtatshme që ka për qëllim denigrimin e dinjitetit të tjetrit, lëndimin, fyerjen apo të ngjashme, gjatë kohës që nxënësit janë brenda kampusit të shkollës, si dhe gjatë kohës që ndodhen jashtë asaj, mirëpo ende mbajnë uniformën e shkollës;
- xi. Ndalohet rreptësisht çdo lloj i ngacmimit të nxënësve dhe komunitetit të shkollës;
- xii. Ndalohet rreptësisht çdo fshehje e informacionit nga nxënësit, në lidhje me shkeljen e këtij Kodi të Etikës dhe Mirësjelljes;
- xiii. Ndalohet rreptësisht çdo lloj plagjiature nga nxënësit;

IX. PRINDËRIT/KUJDESTARËT

a. Të drejtat

- i. Presin që fëmijët e tyre të ndërveprojnë dhe mësojnë në një mjedis të sigurt;
- ii. Informohen për çështjet në lidhje me fëmijët e tyre;
- iii. Përfshihen në zhvillimin e strategjive të shkollës nga të cilat preken drejtpërdrejtë apo tërthorazi fëmijët e tyre.



b. Përgjegjësitë

- i.** Bisedojnë me fëmijët e tyre lidhur me jetën shkollore;
- ii.** Punojnë bashkë me shkollën për zgjidhjen e problemeve;
- iii.** Mbështesin fëmijët e tyre me të gjitha mjetet e tyre për të mësuar dhe studiuar në të gjitha format e mundshme, brenda dhe jashtë klasës, por edhe në ekskursione ose praktika për të cilat shkolla rezervon të drejtën t'i bëjë të detyrueshme;
- iv.** Inkurajojnë fëmijët që të respektojnë rregullat e shkollës;
- v.** Marrin pjesë në mbledhjet e organizuara kolektive, por gjithashtu duhet të tregojnë interesim për fëmijët e tyre gjatë gjithë vitit, duke kërkuar informata nga secili mësimdhënës;
- vi.** Përkrahin aktivisht aktivitetet e shkollës, si në Ditën e Dyerve të Hapura;
- vii.** Janë aktivë dhe plotësisht të sinqertë në shprehjen e mendimit, sugjerimeve apo paraqitjen e ankesave, gjë që duhet t'i përmbahet respektimit të hierarkisë. Kjo nënkupton se gjitha shqetësimet e tyre mund të shprehen së pari tek arsimtari i lëndës (nëse problemi qëndron në një lëndë përkatëse), tek kujdestari i klasës (për çfarëdo problemi) dhe në fund tek udhëheqësia;
- viii.** Tregojnë vullnet dhe gatishmëri për bashkëpunim të bazuar në besim dhe sinqeritet;
- ix.** Sigurojnë mbështetje për mësimdhënësit në zbatimin e kodit të mirësjelljes.

X. PËRDORIMI RESURSEVE

- i.** Punonjësit (dhe nxënësit) duhet ta mbrojnë e ruajnë pronën, mjetet e luajtshme dhe të paluajtshme të shkollës, përfshirë këtu edhe dokumentacionin e shkruar dhe atë elektronik;
- ii.** Të gjithë anëtarët e komunitetit të ALG-së duhet të kujdesen që të gjitha mjetet e shkollës të shfrytëzohen me kujdesin më të madh dhe në mënyrë sa më efikase;
- iii.** Askush nuk do të përdorë, ose nuk do të lejojë palë të treta të përdorin gjësende që janë pronë e shkollës për qëllime dhe nevoja private;
- iv.** Të gjithë kanë për detyrë të raportojnë çdo mashtrim apo vjedhje ndaj shkollës, për të cilën kanë informata;
- v.** Asnjë mjet apo pronë e shkollës nuk mund të blihet, apo shitet pa miratimin paraprak të mekanizmit përgjegjës;
- vi.** Të gjithë duhet të komunikojnë me respekt kur përdorin teknologjinë e shkollës dhe mediat sociale, si dhe të raportojnë shqetësimet e tyre tek mekanizmat e duhur brenda komunitetit të shkollës;
- vii.** Edhe pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës, ish-punonjësit e shkollës detyrohen t'i ruajnë fshehtësitë e shkollës dhe nuk duhet të zbulojnë çfarëdo informate në lidhje me shkollën, të siguruar gjatë kohës sa kanë qenë në marrëdhënie pune;
- viii.** Të gjithë duhet të parkojnë veturat e tyre me kujdes dhe të ngasin me kujdes të shtuar në brenda kampusit dhe jashtë saj.



XI. VEPRIMET QË MUND TË NDËRMERREN NËSE KODI I ETIKËS DHE MIRËSJELJES ËSHTË SHKELUR

- i. Veprimet dhe masat që ndërmerren nëse ky kod apo aktet e brendshme të tjera shkelen dhe përcaktimi i rëndësisë së shkeljes janë të përcaktuara me Aktet e Brendshme të shkollës, në përputhje me ligjin e aplikueshëm në Kosovë.
- ii. Mungesa e njohurive mbi ligjet, rregulloret e brendshme dhe aktet nënligjore nuk e arsyeton shkeljen e bërë nga punonjësit. Çdo individ është përgjegjës për të njohur dhe respektuar këto rregulla. Në rast se ndjejnë paqartësi ose dyshime në lidhje me interpretimin e këtyre rregullave, punonjësit janë të obliguar të kërkojnë udhëzime dhe sqarime nga drejtorit ekzekutiv. Kjo është e rëndësishme për të siguruar një mjedis pune të sigurt dhe të respektueshëm;
- iii. Sjelljet e kundërligjshme dhe joetike janë të ndaluara dhe sjellin pasoja për të gjithë;
- iv. Kurdo që është e mundur, do të ndërmerren masa për të ndihmuar në ngritjen e vetë-disiplinën dhe për të ndihmuar me problemet që mund të çojnë në sjellje të papranueshme.
- v. Kur është e përshtatshme, veprimi do të merret si një pasojë e drejtpërdrejtë e gabimeve;
- vi. Në përgjithësi, mësimdhënësit do të merren me raste të sjelljes së papranueshme në klasë, por raste të sjelljes së keqe të vazhdueshme, ose ekstreme trajtohen nga udhëheqësia dhe/ose drejtoria e shkollës;
- vii. Në disa raste, mund të bëhet referimi për këshilltarin/këshilltaren e shkollës;
- viii. Është politikë e shkollës të njoftojë dhe të këshillohet me prindërit për të gjitha shkeljet serioze, ose të vazhdueshme të rregullave të shkollës. Komunikimi i hapur me prindërit është thelbësor për të siguruar që ata të jenë të informuar dhe të përfshirë në procesin edukativ të fëmijëve të tyre;
- ix. Është politikë e shkollës të hetojë të gjitha shkeljet e mundshme të rregullave të parashikuara në këtë Kod. Kjo përfshin zhvillimin e bisedave me nxënësit, punonjësit dhe dëshmitarët përkatës, si dhe analizimin e dëshmive dhe informacioneve të tjera lidhur me to. Ky proces është i nevojshëm për të siguruar një vendim të drejtë dhe të bazuar në prova.
- x. Shkeljet e këtij Kodi mund të rezultojnë në veprime disiplinore. Këto veprime mund të përfshijnë, por nuk kufizohen vetëm në tërheqjen e vërejtjes me shkrim apo gojë, suspendimin, ose edhe ndërprerjen e kontratës për individët që shkelin rregullat. Këto masa janë të nevojshme për të mbajtur një mjedis të sigurt dhe të respektueshëm..
 - a. Në arritjen e vendimit të shqiptimit të masave disiplinore të përcaktuara sipas këtij neni merret parasysh serioziteti i shkeljes, historia e kaluar e individit dhe rrethanat shtesë të çështjes në fjalë;
 - b. Secili punonjës apo nxënës do ta ketë rastin ta tregojë anën e saj/tij të rrjedhimit të ngjarjeve në rast të ngarkimit me shkelje të akteve të brendshme;
 - c. Në rast të çështjeve të punonjësve të dërguara tek Komisioni Disiplinor apo komisioni adekuat, derisa të vlerësohet çështja nga komisioni disiplinor apo komisioni adekuat, Drejtorit ekzekutiv mund të ndërmarrë masa ndëshkuese deri në suspendim;



- d. Vendimin lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës e merr Drejtori ekzekutiv i shkollës sipas udhëzimit të komisionit disiplinore apo komisioneve adekuate;
- e. Procedura pranë Komisionit disiplinor zhvillohet në përputhje me rregulloren për punën e Komisionit disiplinor pranë "Loyola-Gymnasium".

XII. DISPOZITA TË TJERA

- i. Shkolla e ruan të drejtën që të ndryshojë dispozitat e parapara me këtë Kod të Etikës dhe Mirësjelljes në çdo kohë, pa paralajmërim;
- ii. Të gjithë punonjësit do të informohen në lidhje me ndryshimet e aplikuara ndaj këtij Kodi në afat kohor të arsyeshëm prej një (1) jave;
- iii. Ky Kod hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Drejtori ekzekutiv dhe kumtimit të hyrjes në fuqi te palët e interesuara.

Prizren,

Data: 09.10.2024

z. Martin Jann
Drejtor Ekzekutiv i Asociation "Loyola-Gymnasium"



ASOCIATION


“LOYOLA-GYMNASIUM”

CODE

OF

ETHICS AND CONDUCT

Prizren, September 2024



Content

I. INTRODUCTION	3
II. PURPOSE OF THE DOCUMENT	3
III. GENERAL PROVISIONS.....	3
IV. SCHOOL STAFF.....	4
a. Rights:.....	4
b. Obligations:.....	4
V. SCHOOL LEADERSHIP.....	5
a. Rights:.....	5
b. Obligations:.....	5
VI. SCHOOL DIRECTOR.....	5
a. Rights:.....	5
b. Obligations:.....	5
VII. TEACHERS	6
a. Rights:.....	6
b. Obligations:.....	6
VIII. STUDENTS.....	6
a. Rights:.....	6
b. Obligations:.....	7
c. Prohibitions:.....	8
IX. PARENTS/GUARDIANS	9
a. Rights	9
b. Obligations.....	9
X. USE OF RESOURCES.....	10
XI. ACTIONS THAT CAN BE TAKEN IF THE CODE OF ETHICS AND CONDUCT IS VIOLATED.....	10
XII. OTHER PROVISIONS	12



I. INTRODUCTION

Based on Article 5, point (i) of the Law on Education in the Municipalities of the Republic of Kosovo, the Law on Pre-University Education in the Republic of Kosovo No. 04/L-032 and Article 84 of the Labor Law of the Republic of Kosovo no. 03/L-212 dated 01.XI.2010, and based on the contributions from the workshop held with the administrative and educational staff of the school on August 25th, 2017, after the meeting of the General Council of the School on 01.11.2017, Asociation Loyola Gymnasium (hereinafter also referred to as "ALG") approves this Code of Ethics and Conduct.

II. PURPOSE OF THE DOCUMENT

Loyola-Gymnasium is a place where students and young people learn and understand the history and roots of humanity, acquire knowledge and the habit of creating ideas, learn to enjoy achievements and face losses, and develop the necessary tools for building a future of common. In this way, our school tries to encourage its students with competence, awareness and compassionate commitment.

At the same time we try to provide education for democracy which is the key element for the democratic development of a country.

Moreover, we see ourselves as an element in the education system of Kosovo, therefore, based on the agreement on the establishment of the school, we respect the laws and guidelines of Kosovo.

To achieve these goals, Loyola-Gymnasium must be a safe place where everyone is aware of their rights and duties. Our Code of Ethics and Conduct provides guidance so that purposeful learning occurs and the needs of all are met.

III. GENERAL PROVISIONS

a. The Code of Ethics and Conduct provides for a series of ethical rules and principles that all members of the "Loyola-Gymnasium" school community (hereinafter referred to as the "School") must adhere to, regardless of position, age, gender, ethnicity, religion, or political determination.

b. The Code of Ethics and Conduct regulates the rights and obligations of the holders of direct educational activities related to appropriate behavior towards other employees, colleagues, school students, peers, parents of students and other parties.



- c. The Code of Ethics and Conduct promotes an ethical culture of interaction in the work done for the school through the creation of a healthy work environment, dominated by correct relations of cooperation, respect for applicable laws and internal regulations, and objectivity in the performance of tasks for all members of the school community.
- d. School employees participate in establishing, maintaining and enforcing high standards of conduct so that respect, honesty, impartiality and objectivity of the school is protected both internally and externally.
- e. The entire staff of school employees has the duty to contribute towards the creation of a positive and productive work environment.
- f. The workplace, according to this Code of Ethics and Conduct, means any working space where the employee performs work and duties.
- g. The school premises are dedicated to the entire ALG community.
- h. In principle, students stay in classrooms only in the presence of teachers.
- i. Fields and sports halls can also be entered only under the supervision of the teacher in charge, taking into account the rules in force on their use.

IV. SCHOOL STAFF

a. Rights:

- i. To be treated fairly and equally;
- ii. To be treated with respect;
- iii. To be informed on time about the changes in the school;
- iv. To file complains without feeling discriminated against.

b. Obligations:

- i. Comply with: laws, internal regulations, by-laws, work practices and general labor standards that are applicable in Kosovo;
- ii. Behave with the utmost respect and act in a professional and in an impartial manner, both towards students and their colleagues;
- iii. Perform their duties in full compliance with the principles of objectivity, fairness, transparency and non-discrimination;
- iv. Perform their work honestly, diligently and with high responsibility;
- v. To avoid any illegal activity or participation in acts discrediting the school;
- vi. Respect and contribute to the legitimate and ethical objectives of the school;
- vii. Actively participate in the development of various school strategies related to their work;
- viii. Are prudent in the use and protection of the information provided during the performance of their duties;



- ix. Take care of keeping the school premises clean;
- x. Pay attention to waste classification;
- xi. present the damage and impurities to the administration or to the homeroom teachers so that the problem can be avoided.

V. SCHOOL LEADERSHIP

a. Rights:

- i. Expect cooperation from all colleagues, students and parents;
- ii. Welcome contributions and proposals for the development and improvement of quality in teaching and learning;
- iii. They are consulted in case of any ambiguity, especially in cases where other parties, such as homeroom teachers, parent representative, etc. do not result in success.

b. Obligations:

- i. Ensure conditions for all those involved in school life to perform their duties and exercise their rights;
- ii. Support and guide staff members;
- iii. Develop the school's pedagogical development process, identify and correct possible deviations and equip the school with all the necessary tools, such as personnel, infrastructure and programs;
- iv. Accept and investigate complaints addressed to them.

VI. SCHOOL DIRECTOR

a. Rights:

- i. Expects loyalty, sincerity and cooperation from all colleagues and students but also from parents;
- ii. Designate a colleague to take responsibility for certain clearly defined tasks.

b. Obligations:

- i. Exercises care for the implementation of laws, internal regulations, by-laws, as well as ensure that work practices and general work standards are in accordance with the practices and standards that are applicable in Kosovo;
- ii. Ensures that all employees receive a copy of this Code and read and understand its requirements;
- iii. Ensures that all employees understand their duty to report violations, suspected acts or



legal irregularities of this Code.

VII. TEACHERS

a. Rights:

- i. Expect the cooperation of students during the implementation of their curriculum;
- ii. Expect that they will be able to learn in an orderly and cooperative environment;
- iii. Expect the support of other personnel and the administration in fulfilling their professional duties;
- iv. Maintain flexibility in their approach to classroom procedures and organization within school policy;

b. Obligations:

- i. Treat students fairly on an ongoing basis;
- ii. Offer an appropriate range of learning strategies;
- iii. Undertake student counseling and leadership roles when appropriate;
- iv. Develop students' awareness and understanding of school rules;
- v. Discover and support the talent of any potential student;
- vi. Support students and actively participate in all school events foreseen as mandatory (eg school holidays, awareness days, sports holidays, excursions);
- vii. They give their proposals in all areas of school life;
- viii. Are initiators of various educational and cultural activities;
- ix. Follow approved school policies and procedures regarding student management;
- x. Communicate with parents and guardians on issues related to their children's educational development and behavior;
- xi. Are punctual and prepared;
- xii. Dress formally, in a regular outfit that does not spoil the image of the school;
- xiii. Use respectful language at school and with all parties;
- xiv. Homeroom teachers are dedicated to their duty as responsible for the students of a class with will and impartiality;
- xv. Monitoring teachers carry out their work with full responsibility by adhering to the care plan.

VIII. STUDENTS

a. Rights:



- i. Feel safe at school;
- ii. Learn in a challenging environment to the best of their ability;
- iii. Are treated with respect by other students and teachers;
- iv. Are heard by teachers and other students;
- v. Use school resources for development purposes, with the permission and supervision of teachers or administrative staff;
- vi. Are informed about new developments within the school;
- vii. Give their proposals in all areas of school life, especially in teaching.

b. Obligations:

- i. Accept the school's policies regarding their behavior;
- ii. Respect the Code of Ethics and Conduct, the internal rules and any other act of the school;
- iii. Act and work together with other students and teachers;
- iv. Respect the learning needs of other students;
- v. Take progressive responsibility for their own advancement, work consistently and complete tasks as required;
- vi. Are tolerant of differences between peers;
- vii. Follow the teaching process and participate in all school events foreseen as mandatory (eg school holidays, awareness days, sports holidays, excursions).
- viii. Engage with all their means to learn and study in all possible forms, inside and outside the classroom, but also in excursions or practices for which the school reserves the right to make them compulsory;
- ix. Wear their uniform regularly the entire time they are at school. In the classroom, the student cannot wear anything other than the uniform;
- x. Uphold the reputation of the school by maintaining an appropriate standard of behavior and appearance in transit to and from school, especially when wearing school uniform;
- xi. Visible tattoos, piercings and inappropriate hairstyles are not permitted and may result in suspension or expulsion;
- xii. Inform parents about their educational progress and convey communication from the school effectively;
- xiii. Accept the authority of staff members and respect the special rules which may be made from time to time;
- xiv. Behave in a way that does not endanger the health and safety of yourself or others, including mental health;
- xv. Behave with courtesy and consideration for others. In particular, students must refrain from all forms of bullying as outlined in the school's Child Protection Policy;
- xvi. Must avoid inappropriate behavior with each other and the school community while



- wearing and representing the school uniform, regardless of whether the inappropriate behavior occurs on or off the school campus;
- xvii. Be transparent with school staff about any inappropriate behavior of school students and the school community;
 - xviii. Refrain from inappropriate actions and behaviors that would have a negative impact on the reputation of the school and its community;
 - xix. Refrain from behavior that would disrupt the work of any class or interfere with the learning opportunities of other students;
 - xx. To not use someone else's academic work and pass it off as your own without citing the source of that information;
 - xxi. To not submit the same paper more than once;
 - xxii. To not cheat on tests, exams, quizzes or any other form of assessment;
 - xxiii. To not help another student achieve any success by cheating;
 - xxiv. Get permission from the school management in case they want to distribute or sell newspapers, leaflets or the like in the school premises;
 - xxv. Obtain the authorization of the school management in case of opening any website or account on any social media, since they cannot represent the school on social media;
 - xxvi. Students who do not stay in the dormitory (externals) are obliged to adhere to the general rules of the school, which are based on the rules of the boarding school;
 - xxvii. Students who stay in the dormitory (internals) at no time should use their presence in the dormitory to create any advantage in relation to non-boarders, because obligations and tasks at school and extracurricular activities (excursions, cultural, artistic, sports activities, etc.) apply to everyone.

c. Prohibitions:

The prohibitions set forth in this Code of Ethics and Conduct apply to students while they are inside the school campus, outside of whether they are still wearing the uniform, on official school trips abroad, on field trips or similar. Violation of these rules, including the violation of responsibilities, gives the school the right to impose adequate measures in accordance with the applicable internal acts.

- i. Smoking/possession of tobacco, narcotic substances and other substances is strictly prohibited, both inside and outside the school campus, including any school-related premises during school or extracurricular activities;
- ii. The use of mobile phones and any other electronic devices during lessons or school activities is strictly prohibited, except in cases approved by the teachers for educational or informative purposes in relation to their families;
- iii. The use of mobile phones and any other electronic devices during lessons or school activities is strictly prohibited, except in cases approved by the teachers for educational or informative purposes in relation to their families;



- iv. Students must respect the dress code set by the school, the uniform, and it is forbidden to wear clothes with offensive, discriminatory messages, or that promote violence and illegal substances;
- v. It is forbidden to leave the campus during school hours without the permission of the guardian teacher or the school directorate, or to leave the school for a longer period of time which would have a negative impact on the student's school year;
- vi. Possession of any type of weapon, cold weapon or dangerous object that can be used to harm oneself or others is strictly prohibited;
- vii. Any type of violence against other students or other persons inside the school environment is strictly prohibited, as well as any type of violence by students during the time when students wear the school uniform;
- viii. Any form of intentional damage to school property or others is prohibited and will be punished in accordance with school rules and applicable legislation;
- ix. Any student behavior that endangers safety during the transportation of students through means of transport is prohibited;
- x. Any behavior of students towards each other and the school community, which is defined as bullying or inappropriate behavior aimed at denigrating the dignity of another, hurting, insulting or similar, while the students are inside the school campus, is strictly prohibited as well as while they are outside and still wear the school uniform;
- xi. Any type of harassment of students and the school community is strictly prohibited;
- xii. Any concealment of information from students, in relation to the violation of this Code of Ethics and Conduct, is strictly prohibited;
- xiii. Any type of plagiarism by students is strictly prohibited;

IX. PARENTS/GUARDIANS

a. Rights

- i. It is expected that their children to interact and learn in a safe environment;
- ii. Be informed about issues related to their children;;
- iii. They are involved in the development of school strategies that directly or indirectly affect their children.

b. Obligations

- i. Talk to their children about school life;
- ii. Work together with the school to solve problems;
- iii. Support their children with all their means to learn and study in all possible forms, inside and outside the classroom, but also in excursions or practices for which the school reserves the right to make them mandatory;



- iv. Encourage children to respect school rules;
- v. Participate in the organized collective meetings but they must also show interest in their children throughout the year by asking for information from each teacher;
- vi. Actively support school activities, such as Open Doors Day;
- vii. Be active and completely honest in the expression of opinion, suggestions or presenting complaints, which must adhere to the respect of the hierarchy. This means that all their concerns can be expressed first to the subject teacher (if the problem lies in a relevant subject), to the class supervisor/homeroom teacher (for any problem) and finally to the management;
- viii. Show willingness and readiness for cooperation based on trust and sincerity;
- ix. Provide support for teachers in implementing the code of conduct.

X. USE OF RESOURCES

- i. Employees (and students) must protect and preserve the property and movable and immovable assets of the school, including written and electronic documentation;
- ii. All members of the ALG community must ensure that all school assets are used with the utmost care and efficiency;
- iii. No one shall use or allow third parties to use items that are the property of the school for private purposes and needs;
- iv. Everyone has a duty to report any fraud or theft to the school, about which they have information;
- v. No school equipment or property can be bought or sold without the prior approval of the responsible mechanism;
- vi. Everyone should communicate respectfully when using school technology and social media, and report their concerns to the appropriate mechanisms within the school community;
- vii. Even after the termination of the employment relationship, the former employees of the school are obliged to maintain the secrets of the school and must not disclose any information related to the school, obtained during the time they were in the employment relationship;
- viii. Everyone should park their cars carefully and drive with extra care on and off campus.

XI. ACTIONS THAT CAN BE TAKEN IF THE CODE OF ETHICS AND CONDUCT IS VIOLATED

- i. Actions and measures that are taken if this code or other internal acts are violated and the determination of the importance of the violation are determined by the internal acts of the school in accordance with the applicable law in Kosovo.



- ii. Lack of knowledge on laws, internal regulations and bylaws does not justify the violation committed by employees. Each individual is responsible for knowing and respecting these rules. In case they feel unclear or doubtful about the interpretation of these rules, employees are obliged to seek instructions and clarifications from the executive director. This is important to ensure a safe and respectful working environment;
- iii. Illegal and unethical behavior is prohibited and carries consequences for everyone;
- iv. Whenever possible, measures will be taken to help build self-discipline and help with problems that may lead to unacceptable behaviour.
- v. Where appropriate, action will be taken as a direct consequence of the errors;
- vi. In general, teachers will deal with cases of unacceptable behavior in the classroom, but cases of persistent or extreme misbehavior are dealt with by the school management and/or principal;
- vii. In some cases, a referral to the school counselor may be made;
- viii. It is school policy to notify and advise parents of all serious or persistent violations of school rules. Open communication with parents is essential to ensure that they are informed and involved in their children's educational process;
- ix. It is school policy to investigate all possible violations of the rules set forth in this Code. This includes conducting interviews with students, staff and relevant witnesses, as well as analyzing evidence and other relevant information. This process is necessary to ensure a fair and evidence-based decision.
- x. Violations of this Code may result in disciplinary action. These actions may include, but are not limited to, written or verbal reprimand, suspension, or even termination of the contract for individuals who violate the rules. These measures are necessary to maintain a safe and respectful environment.
 - a. In reaching the decision to impose the disciplinary measures determined under this article, the seriousness of the violation, the past history of the individual and the additional circumstances of the case in question are taken into account;
 - b. Each employee or student will have the opportunity to show his/her side of the course of events in case of being charged with a violation of internal acts;
 - c. In case of employee issues sent to the Disciplinary Commission or the appropriate commission, until the case is evaluated by the disciplinary commission or the appropriate commission, the executive director may take punitive measures up to suspension;
 - d. The decision regarding the termination of the employment relationship is taken by the Executive Director of the school according to the instructions of the disciplinary committee or appropriate committees;
 - e. The procedure at the disciplinary committee is carried out in accordance with the regulation for the work of the disciplinary committee at "Loyola-Gymnasium".



XII. OTHER PROVISIONS

- i. The school reserves the right to change the provisions of this Code of Ethics and Conduct at any time, without notice.;
- ii. All employees will be informed about the changes applied to this Code within a reasonable period of one (1) week.;
- iii. This Code enters into force on the day of approval by the Executive Director and notification of the entry into force to the interested parties.

Prizren,

Date: 09.10.2024

Mr. Martin Jann

Executive Director of Association "Loyola-Gymnasium"